



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2351

NR. VENDIMI 2820



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

DHOMA PENALE

Rr Jordan Misja, Tiranë, adresë web: www.gjykatatirana.gov.al

Nr. 2351	Regjistri Themeltar	Numër	2820
	Vendimi		
	Datë Regjistrimi 24.05.2021	Datë	27.10.2021
	Vendimi		

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTARE – MIGENA LASKA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Fahrie Gjoçaj**, pasi përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket:

KËRKUES:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga prokurori **z. Ylli Bashaj**.

Gjykata, pasi dëgjoji prokurorin e çështjes, **z. Ylli Bashaj**, i cili përfundimisht kërkoi:

- *Deklarimin fajtor të të pandehurit Luisiano Meshini për kryerjen e veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe në bazë të nenit 283/1 i K. Penal dhe dënimit e tij me burgim.*

Të pandehurin dhe Avokatin mbrojtës të zgjedhur, të cilët përfundimisht i kërkuan Gjykatës:

- *“Mëshirë – Dënimit e të pandehurit me minimumin e parashikuar nga ligji dhe aplikimin*

e nenit 59 të K.Penal”.

Pasi shqyrtoi dhe administroi provat e paraqitura gjatë këtij gjykimi, Gjykata,

V Ë R E N :

Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka ardhur për shqyrtim gjyqësor themeli, çështja penale e sipërcituar.

Gjykata, bazuar në nenet 74 dhe 76 të K.Pr.Penale, konstaton se është kompetente si në pikëpamjen lëndore ashtu dhe në atë tokësore për të shqyrtuar çështjen gjyqësore penale të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, prokurori e cila është kompetente dhe përgjegjëse për ndjekjen e këtij procedimi penal, të regjistruar për veprën penale konkrete.

Bazuar në kërkesën e të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, të kryer që në seancën paraprake, Gjykata, në zbatim të neneve **403 - 405 të K.Pr.Penale**, pasi e çmoi të mundur shqyrtimin e plotë dhe të drejtë të kësaj çështje në gjëndjen në të cilën ndodhen aktet, vendosi të pranojë kërkesën për “*Gjykim të Shkurtuar*”.

Bazuar në provat e shqyrtuara gjatë hetimit gjyqësor të çështjes, ka rezultuar se:

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se bazë të materialeve të ardhura nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me datë 17.12.2020 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 8983/2020 në ngarkim të të pandehurit **Luisiano Meshini**, akuzuar për kryerjen e veprës penale “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*”, parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal.

Se hetimet e kryera provojnë se mesditën e datës 16.12.2020, grupi i punonjësve të policisë, pjesë e strukturës policore për hetimin e narkotikëve, pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, i përbërë nga Abedin Metko, Xhuljo Nazera, Artan Coli, Endri Demi, Orges Haka, Gersi Leka dhe Andi Kano, në kuadër të verifikimit të një informacioni të marrë në rrugë operative që bënte fjalë për shpërndarje të lëndëve narkotike në rrugën “*Stefan Shundi*”, pjesë e territorit të zonës së njohur si “*Astiri*”, janë planizuar për të shërbyer në këtë vend, për kapjen e shpërndarësve e shitësve të këtyre lëndëve. Kur kanë qënë në këtë territor, rreth orës 12:30, atyre ju ka rënë në sy prezenca e një personi, që ndodhej në hyrje të një pallati, i cili me vonë është identifikuar si i pandehuri **Luisiano Meshini**.

Janë afruar pranë këtij të fundit dhe mbi bazën e dyshimeve të krijuara në vend, ai është kontrolluar në kushtet e flagrancës. Gjatë kontrollit fizik, atij i janë gjetur me vete katër qese plastike, brenda të cilave kishte material bimor, që është dyshuar si lëndë narkotike e llojit Cannabis Sattiva, sasi e cila, pas peshimit, ka rezultuar ishin me peshë 5.6 gram.

Ky fakt ka shërbyer që i pandehuri **Luisiano Meshini** të shoqërohej në banesën e tij, për të kontrolluar edhe ambientet e brendshme të vendit ku ai banonte. Gjatë kontrollit të banesës, në dhomën e gjumit, mbi një komodinë, u gjetën mbetje materiali bimor, ndërsa mbi krevatin martesor, u gjet një kovë, në fundin e së cilës kishte material bimor si dhe tetë qese e

një kavanoz qelqi me dy qese të tjera, me mbetje po të materialit bimor. ¥

Ndërsa në një dhomë gjumi të vogël, u gjetën qese farmaceutike të vogla.

I gjithë materiali bimor i përfshirë në të gjitha qeset është sekuestruar me cilësinë e provës materiale, si material i dyshuar si bimë narkotike të llojit Cannabis Sattiva. E gjithë sasia e materialit tjetër bimor të gjetur në dhomat e banesës është peshuar dhe arrinte peshën **228.8 gram**.

Po në dhomën e fundit të kontrolluar, u gjeten edhe një sasi kartmonedhash të prerjeve të ndryshme. Pas konstatimit të këtyre fakteve i pandehuri **Luisiano Meshini**, i konsideruar si person nën hetim, është shoqëruar në organin e policisë dhe është arrestuar në kushtet e flagrancës.

Nëpërmjet të dhënave të pasqyruara në konkluzionet e aktit të ekspertimit, për materialet në ngarkim të shtetasit Luisiano Meshini, me Nr. 2127 datë 03.03.2021, mësohet se materialet bimore objekt ekspertimi janë Cannabis, produkt herbal të bimës Cannabis Sattiva L dhe pesha e tyre, pa ambalazh është **173.734 gram**.

Ndërsa nëpërmjet të dhënave të pasqyruara në konkluzionet e aktit të ekspertimit toksikologjiko - ligjor të urinës së shtetasit **Luisiano Meshini**, me Nr. 2744 datë 24.12.2021, mesohet se në urinën e tij, u zbulua prania e produkteve të kanabinoidike teëmetabolizmit të bimës Cannabis Sattiva L në organizmin e njeriut.

Të dhënat e pasqyruara në procesverbalin e kqyrjes së pjesshme të telefonit të personit nën hetim **Luisiano Meshini**, të kryer menjëherë pas ndalimit të tij, tregojnë se ky i fundit ka komunikuar hapur me persona të tjerë për shitjen e substancave narkotike. Numrat e kartave SIM të përdorura në bisedat telefonike të realizuara nga i pandehuri e personave të tjerë, blerës të lëndëve narkotike, janë verifikuar në shoqëritë e telefonisë celulare.

Të dhënat e shkresës Nr. 673/1 datë 05.02.2021 dërguar nga Kompania e telefonisë celulare ONE tregojnë se me personin nën hetim **Luisiano Meshini**, kanë komunikuar me telefon edhe shtetasit Blerina Topllari dhe Ilirjan Hodo. Mbi bazën e këtyre të dhënave është komunikuar me shtetasin Ergrent Boshti, i cili i pyetur me cilësinë e personit që ka dijëni për rrethana të hetimit, në deklaratimet e tij ka sqaruar se është përdorues i lëndës narkotike Cannabis Sattiva dhe substancë të tilla narkotike, ka blerë disa herë tek i pandehuri në fjalë.

I pyetur për faktet e mësipërme, i pandehuri **Luisiano Meshini** i pranon ato por edhe akuzën e ngritur ndaj tij, duke pretenduar se nuk ka shitur substanca narkotike.

Bazuar në analizën e të dhënave të mësipërme, organi i akuzës, ka arritur në konkluzionin se me veprimet e tij, i pandehuri **Luisiano Meshini** ka konsumuar elementët e veprës penale “*Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*”, të parashikuar nga neni 283/1 i K. Penal. Vërtetohet se ai është mbajtës dhe shitës i një substance narkotike, por edhe përdorues i kësaj lënde, e cila është pjesë e substancave të ndaluara të listës, bashkelidhur ligjit Nr. 7975 datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”, përdorimi abuziv i të cilave, dëmton

shëndetin dhe krijon varësi te përdoruesit nga këto lëndë.

Për të provuar faktet e mësipërme, nga ana e organit të akuzës janë paraqitur në cilësinë e provës: Proçesverbal për kapjen në flagrancë të shtetasit Luisiano Meshini datë 16.12.2020, përpiluar nga punonjësit e policisë Abedin Metko, Xhuljo Nazeraaj, Artan Coli, Endri Demi, Orges Haka, Gersi Leka dhe Andi Kano; Raport shërbimi i përpiluar nga punonjësit e policisë Abedin Metko, Xhuljo Nazeraaj, Artan Coli, Endri Demi, Orges Haka, Gersi Leka dhe Andi Kano i datës 16.12.2020; Proçesverbal i kontrollit të banesës së shtetasit Luisiano Meshini datë 16.12.2020 dhe tabela fotografike; Proçesverbal përshkrimi e peshimi i provës materiale të dyshuar si lëndë narkotike të gjetur në banesën e shtetasit Luisiano Meshini etj, i datës 16.12.2020; Proçesverbal për marrjen e urinës së shtetasit Luisiano Meshini datë 16.12.2020; Proçesverbal i sekuestrimit të sendeve provë materiale për shtetasin Luisiano Meshini datë 16.12.2020; Proçesverbal i kqyrjes së pjesshme të telefonit të shtetasit Luisiano Meshini; Akt ekspertimi për materialet bimore Nr. 2127 datë 03.03.2021; Proçesverbal deklarimi i shtetasit Ertgrent Boshti datë 03.03.2021; Vertetim i gjëndjes gjyqësore të pandehurit Luisiano Meshini, si dhe në tërësi aktet e proçedimit penal Nr. 8983/2020.

Faktet e mësipërme, organi i prokurorisë i ka provuar me aktet si në vijim:

- *Proçes verbal i arrestimit të të pandehurit në kushtet e flagrancës datë 19.10.2019;*
- *Aktit të ekspertimit kimik nr. 1636 ku rezulton se në përbërjen e pluhurit të sekuestruar të pandehurit konstatohet prania e lëndes narkotike Cannabis Sattiva;*
- *Proçes verbali i sekuestrimit të provës materiale datë 19.10.2019;*
- *Raporti i shërbimit i mbajtur nga punonjësit e policisë datë 19.10.2019.*

Gjykata, pasi ka shqyrtuar objektivisht, të gjitha faktet, rrethanat dhe provat e administruara në seancë gjyqësore, arrin në arsyetimin se jemi përpara konsumimit të elementëve të veprës penale të parashikuar nga neni **283/1 i Kodit Penal**, autori i të cilës provohet të jetë i pandehuri **Luisiano Meshini**.

BAZA LIGJORE E APLIKUESHME:

Neni 283 Kodi Penal

Prodhimi dhe shitja e narkotikëve

1. *Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, **dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.***

2. *Po kjo veprë, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.*

Elementët e konsumuar nga ky i pandehur, pjesë përbërëse dhe ekzistenciale të kësaj veprë penale, rezultojnë si më poshtë:

- **OBJEKTI:** Veprimet e të pandehurit, kanë cënuar marrëdhëniet juridike, të cilat janë vendosur për të siguruar dhe garantuar mbarëvajtjen dhe ecurinë normale në veprimtarinë e organeve shtetërore për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike; në respektimin dhe funksionimin e shtetit ligjor, konform rregullave procedurale ligjore përkatëse. Në mbështetje edhe të akteve ndërkombëtare, për të siguruar kontrollin mbi prodhimin, importimin, eksportimin, shpërndarjen apo përdorimin e drogës narkotike apo të substancave psikotrope të mbrojtura posaçërisht nga K. Penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale.
- **ANA OBJEKTIVE:** Kjo veprë penale, është konsumuar nga i pandehuri me veprime konkludente, duke mbajtur në përdorim lëndë narkotike llojit *cannabis sativa*, të dëmshme për jetën dhe shëndetin, përdorimin e të cilave ligjvënësi (në nenin 283/1 i K.Penal) e ndalon me ligj të sanksionuar në Kodin Penal shqiptar.
Kjo në mbështetje edhe të *Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008* (përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal); *Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 138, datë 16.11.2017*; *Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 17, datë 14.02.2018*.
- **SUBJEKTI:** Gjykata, konstaton se mosha si dhe përgjegjshmëria e të pandehurit, e bën atë të jetë i përgjegjshëm përpara kriterëve ligjore për të mbajtur përgjegjësi për këtë veprë penale.
- **ANA SUBJEKTIVE:** Nga ana subjektive veprimet e të pandehurit janë kryer me dashje direkte.

Caktimi i llojit dhe masës së dënimit.

Në caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, bazuar dhe në parashikimin ligjor të nenit **47 i Kodit Penal**, i cili parashikon se:

“Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale.

Në caktimin e dënimit ndaj personit ajo merr parasysh rrezikshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.

Parimi i individualizimit të dënimit, përbën një nga parimet themelore të këtij instituti të së drejtës penale. Ligjvënësi në individualizimin ligjor udhëhiqet në mënyrë abstrakte nga rrezikshmëria në përgjithësi e veprës penale pa mbajtur këtu parasysh rrethanat të tilla, të cilat lidhen edhe me autorin e veprës penale dhe që janë veçori e individualizimit që bën gjykata.

Me këtë lloj individualizimi gjykata konkretizon, brenda hapësirës që ajo disponon, llojin dhe masën e dënimit konkret, për një veprë që tashmë është kryer *“de facto”* dhe ndaj një subjekti të caktuar.

Pra, me anë të këtij individualizimi kemi kalimin nga faza abstrakte e parashikimit të veprave penale dhe dënimeve përkatëse në rast të kryerjes së tyre, në një fazë më konkrete ku vepra penale është kryer dhe autori i saj ekziston dhe paraqet një rrezikshmëri të caktuar, e cila

do të vlerësohet nga gjykata bashkë me rrethanat e tjera.

Lidhur me individualizimin e dënimit penal, si dhe me caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, Gjykata merr në konsideratë, si më poshtë:

- Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale;
- Rrezikshmërinë shoqërore të autorit të kryerjes së veprës penale;
- Vepra penale e parashikuar në nenin 283/1 i Kodit Penal, bazuar në faktet dhe në rrethanat konkrete të analizuara, është kryer në formën e mbajtjes dhe të shitjes, ndonëse i paqndheuri ka rezultuar njëkohësisht edhe përdorues i veprës penale.
- Sasia e lëndës narkotike e llojit cannabis sativa, e gjetur dhe sekuestruar të pandehurit është në një sasi të konsiderueshme, në total dhe pa amballazh: **173.734 gram.**
- Sendet dhe orenditë e gjetura dhe të sekuestruara në banesën e të pandehurit, sipas proces-verbalit të sekuestrimit të sendeve, datë 16.12.2020, tregojnë dhe provojnë dukshëm formën e kryerjes së kësaj vepre penale, në kuadër të mbajtjes dhe të shitjes së kësaj lënde narkotike.
- I pandehuri rezulton të jetë **i padënuar më parë;**
- I pandehuri është në moshë të re, 26 vjeç.
- Ka arsim të mesëm të përfunduar, në arsim të lartë në vazhdim;
- Është beqar;
- Është gjykuar me masë sigurimi personal “**Arrest në shtëpi**”, të parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale, dhe që nga data 16.12.2020 dhe aktualisht rezulton të ketë vuajtur rreth **1 vit në gjëndje paraburgimi.**
- Sipas vërtetimit të datës 20.10.2021, rezulton që i pandehuri është rekrutuar për të punuar si “agjent ndërmjetësimi” në Agjensinë Imobilare “Century 21” shpk, kjo shoqëruar me kontratën individuale të punës datë 25.10.2021, në 4 fletë; Kjo ndërkohë që i pandehuri që prej datës **16.12.2020 e në vijim është me masë sigurimi “Arrest në shtëpi**”, caktuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, fakt ky që e detyron të pandehurin që të paktën deri në momentin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë lidhur me gjykimin në themel të kësaj çështje, i pandehuri nuk mund të dalë nga ambienti/banesa ku i është caktuar të qëndrojë në kuadër të masës së sigurimit.
- Ka një vlerësim sjellje lëshuar nga Lagja 14, sipas të cilës gëzon një personalitet të mirë në komunitetin ku banon;
- Sipas çertifikatës familjare datë **12.10.2021**, lëshuar nga Njësia Administrative Kashar, rezulton se trangu familjar i të pandehurit përbëhet nga 4 persona, konkretisht: nga babai, nga nëna, nga motra dhe nga i pandehuri. Ky fakt tregon që i pandehuri nuk është i vetmi person dhe familjar, i cili nevojitet domosdoshmërisht për t’i qëndruar pranë dhe shërbyer nënës, e cila sipas dokumentacionit mjekësor të paraqitur, prezanton probleme shëndetësore;
- Gjykata në caktimin e llojit, si dhe të masës së dënimit merr në konsideratë të gjitha rrethanat e analizuara si më sipër, si dhe e mbështet vendim-marrjen e saj në nenin 283/1 të Kodit Penal, në mbështetje të **Vendimin Unifikues të Kolegjeve të**

Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008 (përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal); Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 138, datë 16.11.2017; Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 17, datë 14.02.2018.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata, çmon të deklarojë fajtor të pandehurin **Lusiano Meshini**, për kryerjen e veprës penale të “**Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike**”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodi Penal, duke caktuar një dënim me burgim, në përputhje dhe në përshatje të plotë me të gjitha rrethanat konkrete të konstatuara dhe të marra në analizë si më sipër.

Meqënëse, gjykimi i kësaj çështjeje, u zhvillua në kushtet e nenit 405 të K.Pr.Penale, në aplikim të nenit **406 të K.Pr.Penale**, i pandehuri përfiton uljen e dënimit në masën e 1/3 (një të tretën) e tij.

Përsa i përket provave material, në zbatim të nenit 190/a/b/ç të K.Pr.Penale:

- *Sendet e sekuestruara sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të proçedimit penal nr. 8983/2020, kalojnë në favor të shtetit shqiptar.*
- *Sasia e lëndës narkotike e sekuestruar sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të proçedimit penal nr. 8983/2020, të asgjësohet*
- *Aparati telefonik i markës “Samsung” model SMA260G, dhe portofoli “i zi”, të sekuestruara sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të proçedimit penal nr. 8983/2020, t’i kthehet personit që i takojnë.*

Përsa i përket shpenzimeve.

Shpenzimet hetimore si dhe shpenzimet gjyqësore në bazë të nenit 393/1 dhe 485 të Kodit të Proçedurës Penale i ngarkohen të pandehurit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në bazë të neneve 283/1 – 48 – 49 të Kodit Penal, në mbështetje të **Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 27.03.2008 (përcaktimi i sasisë së lëndës narkotike për përdorim personal); Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 138, datë 16.11.2017; Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 17, datë 14.02.2018**, si dhe neneve 379 e vijues, 406 e vijues të Kodit të Proçedurës Penale,

V E N D O S I:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit **Luisiano Meshini**, për kryerjen e veprës penale të “**Prodhimi dhe shitja e narkotikëve**”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodi Penal dhe dënimin e tij me **6 (gjashtë) vjet burgim**.

2. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale uljen e 1/3-ës së dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin **Luisiano Meshini**, me **4 (katër) vjet burgim**.
 3. Ekzekutimi i këtij vendimi fillon ditën e arrestimit të të pandehurit **Luisiano Meshini**, kryer për llogari të këtij procedimi penal, në datën **16.12.2020**, dhe pjesa e mbetur pa vuajtur, do të kryhet në një burg të sigurisë së zakonshme.
 4. Në bazë të nenit **190/1/a të K.Pr.Penale**, sendet e sekuestruara sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të procedimit penal nr. 8983/2020, kalojnë në favor të shtetit shqiptar.
 5. Në bazë të nenit **190/1/b të K.Pr.Penale**, sasia e lëndës narkotike e sekuestruar sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të procedimit penal nr. 8983/2020, të asgjësohet.
 6. Në bazë të nenit **190/1/ç të K.Pr.Penale**, aparati telefonik i markës “Samsung” model SMA260G, dhe portofoli “i zi”, të sekuestruara sipas procesverbalit “Për sekuestrimin e sendeve” datë 16.12.2020, faqe 36 e fashikullit të procedimit penal nr. 8983/2020, t’i kthehet personit që i takojnë.
 7. Shpenzimet procedurale, si dhe ato gjyqësore në tërësi, i ngarkohen të pandehurit.
 8. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi.
- 9. U shpall, sot në Tiranë, në datë 27.10.2021.**

**SEKRETARE
FAHRIE GJOÇAJ**

GJYQTARE

MIGENA LASKA

Shpenzime gjyqësore	
Njoftime 6 copë x 150.00 =	900.00 Lekë
Shpenzime të Prokurorisë	11 500.00 Lekë
<u>Shpenzime të seancës paraprake</u>	<u>150.00 Lekë</u>
Totali	12 550.00 Lekë